



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.03.2024
REFERENC-Ë:	23/4600/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"AF METAL TECHNOLOGY" Sh.p.k., Klinë Fabrikë për ngjyrosjen dhe zinkimin e metaleve, Grabanicë , Klinë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "AF METAL TECHNOLOGY" Sh.p.k., Klinë, Fabrikë për ngjyrosjen dhe zinkimin e metaleve, Grabanicë , Klinë.  
me Nr. Prot. 23/4600/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin " Fabrikë për ngjyrosjen dhe zinkimin e metaleve, Grabanicë , Klinë.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 23/4600/MMPHI  
Datë: 14.05.2024.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Operatori, "AF METAL TECHNOLOGY" Sh.p.k., Klinë, Fabrikë për ngjyrosjen dhe zinkimin e metaleve, Grabanicë, Klinë, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Fabrikë për ngjyrosjen dhe zinkimin e metaleve, Grabanicë, Klinë, me Nr. Prot. 23/4600/MMPHI.
2. Operatori obligohet:
  - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
  - 2.2. Të monitorohet në vazhdim emisionet në ajër dhe të raportohet në MMPHI, sipas legjislacionit në fuqi.
  - 2.3. Për sistemin menaxhues të mjedisit të ketë personin përgjegjës të profilit mjedisor;
  - 2.4. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

Faqe 2 nga 4

2.5. Të përmbahen kontratës me kompaninë e licencuar për grumbullimin e mbetjeve nga operimi;

### A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "AF METAL TECHNOLOGY" Sh.p.k., Klinë, për veprimtarinë: Fabrikë për ngjyrosjen dhe zinkimin e metaleve, Grabanicë , Klinë me nr.prot. 23/4600/MMPHI, në ngastrën me nr. P-71011023-00278-7 dhe P-71011023-00278-10, zona kadastrale, Grabanicë , Klinë, konstatohet që operatori plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 19/429/1-ZSP/172/19 , të lëshimit me datë: 11.04.2019;
- Raporti i emisionëve në ajër nr.prot. 120, dt. 23.04.2024, të depozituar nga Laboratori "Inkos" sh.p.k.
- Kontrat mbi ofrimin e shërbimeve të mbeturinave dhe deponimin e tyre, të dt.24.04.2024

Andaj bazuar në të cekurat më lartë dhe gjendjes faktike në teren, si dhe plotësimit të kushteve të parapara me legjislacionin mjedisor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Klinë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së